



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 492/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Nenad Lazic dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.492/2019 e datës 18.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me të cilën ka kërkuar që të shpallet i pavlefshëm një fletëvotim në Vendvotimin 0102B/08R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 18.11.2019, ka pranuar ankesën Anr.492/2019 nga subjekti politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 17.11.2019, gjatë ndërrimit të dytë të punës (nga ora 16:00-24:00), në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë procesit të rinumërimit të votave në kutinë e votimit 0102B/08R, është shpallur i vlefshëm 1 fletëvotim, i cili i takon subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilin votuesi ka votuar përmes një "V", në hapësirën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe kjo "V", ka përfshirë edhe hapësirat e subjektit politik me nr.125 dhe subjektit politik me nr.127, ku një votim i tillë, i cili ka përfshirë hapësirat e tri subjekteve politike, sipas paraqitësit të ankesës bie në kundërshtim me Doracakun e Procedurave të Votimit&Numërimit të KQZ-së, i cili precizon mënyrën e votimit, andaj ky fletëvotim sipas të njëjtit duhet të shpallet i pavlefshëm dhe të obligohet KQZ-QNR, që këtë fletëvotim ta largojë nga votat e vlefshme dhe nga rezultati përfundimtar.

Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për të argumentuar pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një mostër të fletëvotimit të pavlefshëm sipas Doracakut të KQZ-së, shtojca 8 dhe një kopje të fletëvotimit nr.0102B/08B, në cilësi të provave materiale.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar përmes email-it, më datë 19.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se lidhur me shpalljen e fletëvotimit të vlefshëm, QNR-ja, në bazë

të procedurës ka vlerësuar se fletëvotimi në fjalë është i vlefshëm për arsye se dihet qëllimi i votuesit dhe nuk ka prekur shkrimin e subjektit tjetër.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutinë e votimit: 0102B/08R, gjatë procesit të rinumërimit, është shpallur i vlefshëm 1 fletëvotim nga ana e QNR-së, në të cilin votuesi ka votuar përmes një "V", në hapësirën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe kjo "V", ka përfshirë edhe hapësirat e subjektit politik me nr.125 dhe subjektit politik me nr.127. Si rezultat i këtyre konstatimeve QNR-ja, me rastin e rinumërimit e ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim.

Subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 4 lidhur me ndryshimin e nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 8 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013, brenda afatit ligjor ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i pavlefshëm sepse bie në kundërshtim me Doracakun e KQZ-së.

Paneli, me rastin e vendosjes sipas ankesës, vlerësoi pretendimet ankimore të paraqitësit të ankesës dhe provat e bashkangjitura, përgjigjen në ankesë të KQZ-së dhe konstatoi se pretendimet e paraqitësit të ankesës me të cilat ka kërkuar që të shpallet i pavlefshëm një fletëvotim në kutinë e votimit 0102B/08R, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të vlefshmërisë, nuk qëndrojnë, pasi që nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, respektivisht në kopjen e fletëvotimit të bashkangjitur, shihet qartë qëllimi i votuesit, megjithëse votuesi me rastin e votimit ka prekur hapësirat e tri subjekteve politike, nga çka rezulton se ky fletëvotim i përmbush kriteret e vlefshmërisë, dhe duhet t'i bashkëngjitet rezultatit përfundimtar të publikuar me datë 07.11.2019.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117 dhe 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 492/2019 më datën 19.11.2019

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

